



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

### **Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë TM2 2019**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin e rezultateve të Statistikave tremujore të tregtisë me pakicë për periudhën TM 2/ 2019 (2013=100).

Këto statistika janë pjesë përbërëse e Programit statistikor të ASK - së, dhe bazohen në deklaratimet e ndërmarrjeve. Ky hulumtim publikohet në baza të rregullta tremujore.

Rezultatet e këtij hulumtimi paraqesin ecurinë në tregtinë me pakicë në periudha tremujore.

Gjithashtu këto rezultate përdoren për nevoja të përpilimit të llogarive kombëtare dhe janë burim i rëndësishëm në përpilimin e Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve në baza tremujore.

*Ky publikim mund t'i nënshtrohet revidimit.*

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i departamentit DSELLK

Ismail Sahiti - shef divizionit,

Hysni Elshani - shef i sektorit,

Muhamet Kastrati - specialist i TI-së për RSB,

Bekim Bojku - zyrtar,

Qendresa Shala Sopaj - zyrtare

Dafina Kumnova - zyrtare,

Ahmet Cakolli - Zyrtar për dizajn.

(E-mail: **economic@rks-gov.net**)

Shtator, 2019

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së,  
z. Isa Krasniqi

## **Simbolet dhe shkurtesat**

- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- NVE - Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
- RSB - Regjistri Statistikor i Bizneseve
- SAN - Statistikat Afatshkurta të Ndërmarrjeve
- TM1 - Tremujori i parë
- TM2 - Tremujori i dytë
- TM3 - Tremujori i tretë
- TM4 - Tremujori i katërt

## **Simbolet**

- : - Mungojnë të dhënat
- n/a - Nuk aplikohet

## Përmbajtja

	Faqe
1	Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës.....4
1.1.	Objektivi ..... 4
1.2.	Metodologjia dhe shtrirja e anketës..... 4
1.3.	Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës..... 4
1.4.	Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave ..... 5
2	Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë.....6
2.1.	Definicione dhe përkufizime ..... 6
2.2.	Treguesit themelorë..... 6
3	Tregtia me pakicë .....7
3.1.	Struktura e qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë..... 7
3.2.	Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë.....8
4	Indeksi i qarkullimit dhe numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë.....9
4.1.	Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë ..... 9
4.2.	Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë ..... 11

## **1 Objektivi, metodologjia dhe shtrirja e anketës**

### **1.1. Objektivi**

Objektivi kryesor i Anketës së Statistikave afatshkurtra të ndërmarrjeve tregtare është paraqitja e trendëve nëpër periudha tremujore në sektorin e tregtisë me pakicë, nëpërmjet disa treguesve ekonomik, që mundëson krahasueshmërinë e të dhënave në nivel ndërkombëtar duke pasur parasysh standardet Evropiane për statistikën tremujore. Anketa synon t'i plotësojë kërkesat për informacione më të plota statistikore në kushtet e ekonomisë së tregut dhe ofron të dhëna mbi aktivitetet ekonomike të ndërmarrjeve në sektorin e tregtisë me pakicë.

### **1.2. Metodologjia dhe shtrirja e anketës**

Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve ekonomike në sektorin e tregtisë me pakicë, publikojnë të dhënat për tremujorin e dytë 2019 sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2.

Anketa mbulon në mënyrë të përmbledhur, sektorin e tregtisë me pakicë me përjashtim të tregtisë (shpërndarjen) e energjisë me pakicë.

Metodologjia e përdorur për përpilimin e instrumenteve për anketë, nomenklatura dhe përgatitja e të dhënave për publikim, është sipas rregullave dhe rekomandimeve të EUROSTAT-it. Pyetësi është përpiluar në bashkëpunim me Ekspert të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Anketa është kryer në tërë territorin e Kosovës dhe përfshinë sektorin e tregtisë me pakicë.

### **1.3. Korniza për mostër dhe përzgjedhja e mostrës**

Për krijimin (përcaktimin) e kornizës së mostrës janë shfrytëzuar të dhënat nga regjistri statistikor i bizneseve. Të gjitha ndërmarrjet që kanë deklaruar njërin nga tatimet gjatë viteve referuese për vitet paraprake janë konsideruar aktive. Përzgjedhja e mostrës është bërë në bazë të kriterit ku janë përfshirë të gjitha ndërmarrjet që përfaqësojnë 80% të qarkullimit për aktivitetin përkatës të NVE Rev2. Numri i ndërmarrjeve të përfshira në anketë është 846, në sektorin e tregtisë me pakicë.

#### **1.4. Procedurat e mbledhjes (grumbullimit) së të dhënave**

Mbledhja e të dhënave nga terreni është realizuar me anë të anketuesve, kryesisht duke zbatuar metodën e intervistimit të drejtëpërdrejtë të ndërmarrjeve të përzgjedhura nga ana e anketuesve përmes Pyetëtorit. Po ashtu janë shfrytëzuar edhe metodat e lënies së pyetëtorit tek bizneset e në raste të caktuara edhe metoda e dërgimit të pyetëtorit në formë elektronike apo e-mailit.

Anketa në teren del 20 ditë pas përfundimit të tremujorit dhe afati për grumbullimin e të dhënave nga terreni është 30 ditë pas daljes në terren.

## 2 Definicione, përkufizime dhe treguesit themelorë

### 2.1. Definicione dhe përkufizime

**Ndërmarrja** - është njësia më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

**Ndërmarrje aktive** - konsiderohen vetëm ato ndërmarrje që kanë deklaruar njërin nga tatimet apo ndonjë të punësuar për vitin referues.

**Vlera e qarkullimit nga tregtia** - paraqet qarkullimin e realizuar nga tregtia duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres.

$$P_L = \frac{\sum(p_{c,t_n} \cdot q_{c,t_0})}{\sum(p_{c,t_0} \cdot q_{c,t_0})}$$

**Indeksi i vlerës së qarkullimit nga tregtia me pakicë** - paraqet ndryshimin në një tremujor të qarkullimit nga tregtia me pakicë krahasuar me mesataren tremujore të vitit bazë (2013).

**Numri i të punësuarve** - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë që punojnë në ndërmarrje (përjashtuar pjesëtarët e familjes që punojnë pa pagesë).

**Indeksi i Numrit të punësuarve** - Indeksi i punësimit paraqet ecurinë e punësimit në ndërmarrjet e anketuara.

### 2.2. Treguesit themelorë

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2013=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** - Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlerësime të koeficientëve të përdorur etj.

### **3 Tregtia me Pakicë**

#### **3.1. Struktura e qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë**

##### **Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e parë 2019**

Në tremujorin e dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, rritje kanë: Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar 15.4%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 11.0%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 3.3% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 0.3%.

Derisa gjatë këtij tremujori rënie kanë shënuar Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara (19.1%), Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara (10.6%), Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje (6.5% dhe Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara (6.2 %).

##### **Tremujori dytë 2019 - Tremujorin e dytë 2018**

Në tremujorin e parë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018, rritje kanë: Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 14.7 %, Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara 10.0%, Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje 7.5% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 0.5%.

Derisa rënie ka shënuar Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara (8.7%), Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara (6.8%), Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara (3.3%) dhe Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar (2.2%).



## **3.2. Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë**

### **Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e parë 2019**

Në tremujorin e dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019, rritje të numrit të punëtorëve ka: Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 16.0%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 3.4%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 2.6% dhe Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 0.3%.

Derisa rënie kanë shënuar: Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara (12.6%), Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara (9.5%), Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje (3.6%) dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara (0.6%).

### **Tremujori i dytë 2019 - Tremujorin e dytë 2018**

Në tremujorin e parë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2018, është shënuar rritje në të gjitha aktivitetet: Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara 21.9%, Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje 14.1%, Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara 8.5%, Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara 3.7%, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuara 2.4%, Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara 1.9% dhe Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara 1.7%.

Derisa rënie ka shënuar Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara (4.2%).


## 4 Indeksi i qarkullimit dhe numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë

### 4.1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë

Tab.1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2013 = 100)

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik											%
		2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2	
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	137.6	145.4	141.4	146.4	156.3	169.2	170.4	174.1	169.6	170.1	
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	91.0	104.4	103.7	109.4	131.2	146.8	149.9	152.4	153.0	136.8	
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	105.8	107.0	108.6	118.1	127.2	138.6	136.5	135.2	117.5	135.6	
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	137.3	113.9	117.0	127.4	157.1	136.4	116.3	112.8	132.8	124.6	
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	149.8	152.9	156.4	162.7	163.7	179.1	204.4	204.9	198.9	205.5	
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	39.4	41.0	41.0	41.0	44.3	45.8	49.9	57.6	62.3	50.4	
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	127.1	110.2	109.7	117.8	108.3	118.9	115.8	105.3	103.6	115.0	
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	114.4	118.8	138.9	140.0	153.9	158.8	170.1	178.1	182.7	170.7	

Figura 1. Indeksi i qarkullimit në sektorin e tregtisë me pakicë (2013=100)



**Tab 1a. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	%									
		2017 TM1 2016 TM4	2017 TM2 2017 TM1	2017 TM3 2017 TM2	2017 TM4 2017 TM3	2018 TM1 2017 TM4	2018 TM2 2018 TM1	2018 TM3 2018 TM2	2018 TM4 2018 TM3	2019 TM1 2018 TM4	2019 TM2 2019 TM1
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	0.3	5.7	-2.7	3.5	6.8	8.2	0.7	2.1	-2.6	0.3
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	2.2	14.8	-0.7	5.5	19.8	11.9	2.1	1.6	0.4	-10.6
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	-2.6	1.1	1.6	8.7	7.7	9.0	-1.5	-1.0	-13.1	15.4
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	0.0	-17.0	2.7	8.9	23.3	-13.2	-14.7	-3.1	17.8	-6.2
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	-2.4	2.0	2.3	4.0	0.6	9.4	14.1	0.3	-3.0	3.3
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	0.0	4.2	0.0	0.0	7.9	3.5	9.0	15.3	8.2	-19.1
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-1.1	-13.3	-0.5	7.4	-8.1	9.8	-2.6	-9.0	-1.6	11.0
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	0.1	3.8	16.9	0.8	9.9	3.2	7.1	4.7	2.6	-6.5

**Tab 1b. Ndryshimi i indeksit të qarkullimit të tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**


Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	%									
		2017 TM1 2016 TM1	2017 TM2 2016 TM2	2017 TM3 2016 TM3	2017 TM4 2016 TM4	2018 TM1 2017 TM1	2018 TM2 2017 TM2	2018 TM3 2017 TM3	2018 TM4 2017 TM4	2019 TM1 2018 TM1	2019 TM2 2018 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	13.3	16.6	11.8	6.8	13.6	16.4	20.5	19.0	8.5	0.5
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	17.9	22.2	21.3	23.0	44.2	40.5	44.6	39.2	16.6	-6.8
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	10.9	13.1	17.3	8.8	20.3	29.6	25.7	14.5	-7.6	-2.2
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	16.3	-3.3	1.4	-7.3	14.4	19.7	-0.5	-11.5	-15.4	-8.7
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	15.1	-2.5	-0.6	6.0	9.2	17.1	30.6	25.9	21.5	14.7
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	29.4	31.6	34.3	4.2	12.4	11.7	21.7	40.3	40.8	10.0
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	-0.9	-1.1	-0.9	-8.3	-14.8	7.9	5.6	-10.6	-4.3	-3.3
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	13.6	0.6	22.4	22.5	34.5	33.7	22.5	27.2	18.7	7.5

## 4.2. Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë

**Tab 2. Indeksi i numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	%									
		2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	129.9	137.5	139.7	152.5	153.5	157.6	160.3	160.7	161.3	160.3
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në dyqane të specializuara	108.1	104.5	105.7	119.1	119.8	127.7	127.3	120.6	132.0	132.4
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	117.1	114.9	115.9	122.8	123.4	134.4	129.8	121.2	133.1	137.6
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të specializuara	96.1	95.9	98.3	70.5	71.1	83.4	85.8	89.4	87.7	101.7
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	132.9	133.8	136.1	130.1	131.0	139.9	142.2	141.7	138.9	142.6
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të specializuara	118.3	95.8	95.8	112.7	95.8	95.8	101.4	89.4	101.4	91.8
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	110.6	108.4	109.0	82.8	83.2	105.5	114.8	121.8	130.9	114.4
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	42.0	49.4	60.7	52.2	52.2	59.6	68.7	67.2	69.8	68.0

**Figura 2. Numri i të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë (2013=100)**



**Tab 2a. Ndryshimi i indeksit numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha tremujore në raport me tremujorin paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	%									
		2017 TM1 2016 TM4	2017 TM2 2017 TM1	2017 TM3 2017 TM2	2017 TM4 2017 TM3	2018 TM1 2017 TM4	2018 TM2 2018 TM1	2018 TM3 2018 TM2	2018 TM4 2018 TM3	2019 TM1 2018 TM4	2019 TM2 2019 TM1
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	0.2	5.9	1.6	9.2	0.6	2.7	1.7	0.2	0.4	-0.6
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në	3.4	-3.3	1.1	12.6	0.7	6.6	-0.3	-5.2	9.4	0.3
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	0.8	-1.9	0.8	6.0	0.4	8.9	-3.4	-6.6	9.8	3.4
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të	-1.7	-0.2	2.6	-28.3	0.9	17.2	2.9	4.2	-1.9	16.0
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	0.4	0.7	1.7	-4.4	0.7	6.8	1.7	-0.3	-2.0	2.6
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të	23.5	-19.0	0.0	17.6	-15.0	0.0	5.9	-11.8	13.4	-9.5
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	0.3	-2.1	0.5	-24.0	0.5	26.8	8.8	6.1	7.5	-12.6
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	-15.9	17.6	23.0	-14.0	0.0	14.1	15.2	-2.2	4.0	-2.6

**Tab 2b. Ndryshimi i indeksit të numrit të të punësuarve në sektorin e tregtisë me pakicë nëpër periudha në raport me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak**

Nëngrupi (NACE Rev.2)	Aktiviteti ekonomik	%									
		2017 TM1 2016 TM1	2017 TM2 2016 TM2	2017 TM3 2016 TM3	2017 TM4 2016 TM4	2018 TM1 2017 TM1	2018 TM2 2017 TM2	2018 TM3 2017 TM3	2018 TM4 2017 TM4	2019 TM1 2018 TM1	2019 TM2 2018 TM2
471	Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara	4.6	8.2	7.6	17.7	18.2	14.6	14.8	5.4	5.1	1.7
472	Tregtia me pakicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe duhanit, në	-4.8	1.1	2.3	13.9	10.9	22.2	20.4	1.3	10.2	3.7
473	Tregtia me pakicë e karburantit për automjete, në dyqane të specializuar	5.7	4.3	0.3	5.8	5.3	16.9	12.0	-1.3	7.9	2.4
474	Tregtia me pakicë e pajisjeve informatike dhe të komunikimit, në dyqane të	44.6	0.6	3.0	-27.8	-26.0	-13.0	-12.7	26.8	23.3	21.9
475	Tregtia me pakicë e pajisjeve të tjera shtëpiake në dyqane të specializuara	24.2	6.8	7.1	-1.7	-1.5	4.5	4.5	9.0	6.1	1.9
476	Tregtia me pakicë e mallrave kulturore dhe të argëtimit, në dyqane të	31.3	-5.6	-5.6	17.6	-19.0	0.0	5.9	-20.6	5.9	-4.2
477	Tregtia me pakicë e mallrave të tjerë në dyqane të specializuara	35.4	-1.3	-0.8	-24.9	-24.8	-2.6	5.4	47.1	57.3	8.5
479	Tregtia me pakicë jo në dyqane, tezga ose tregje	-2.6	6.1	17.6	4.5	24.3	20.7	13.1	28.6	33.7	14.1

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshafi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>